



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 14 G2/ prot.
4

Tiranë më 5.11.2018

REKOMANDIM

Nr. 26, datë 5.11.2018

PËR KONTROLLUESIN MEDRESEJA "H. MAHMUD DASHI"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Medreseja "H. Mahmud Dashi".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 238 datë 01.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit Medreseja "H. Mahmud Dashi", me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Medreseja "H. Mahmud Dashi", Tiranë.

Medreseja "H. Mahmud Dashi" ushtron aktivitetin në fushën e edukimit parauniversitar dhe ushtron veprimtarinë si shkollë 9-vjeçare dhe e mesme.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Medreseja "H. Mahmud Dashi" është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të kategorive "punonjës", "nxënës" dhe "prindër".

Nga hetimi administrativ pranë këtij kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstatoi se:

1. Kontrolluesi Medreseja "H. Mahmud Dashi" Tiranë, ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr.

9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", por konstatohet se është i nevojshëm përditësimi i këtij "Njoftimi" sa i përket fushës së veprimtarisë, kategorive të subjekteve të të dhënave, kategorive të të dhënave që përpunohen, qëllimet e përpunimit, marrësit e të dhënave etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe nenit 22 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore specifike për "Mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale";
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Ambientet e brendshme në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitet, janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-survejmimit (CCTV). Konstatohet që ka tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejmimit (CCTV). Kontrolluesi disponon rregullore për mbarëvajtjen e këtij sistemi.
5. Në zbatim të akt marrëveshjes me objekt "Ruajtjen dhe sigurinë fizike të ambienteve" me "Alsig shpk" e cila, në cilësinë e përpunuesit ka detyrim ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat personale që akseson, nuk janë parashikuar detyrimet e përpunuesit sipas nenit 20 të ligjit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimit nr.19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

6. Kontrolluesi nuk ka publikuar "Politikat e Privatësisë" në portalin zyrtar <http://medresejatirane.com>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1 të ligjit - "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...".

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi Medreseja "H. Mahmud Dashi" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dëgjimore dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Në vijim, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e shpejtë për përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse të kontrolluesit, i cili ka përditësuar "Njoftimin" mbi përpunimin e të dhënave, ka përcaktuar kushte dhe kritere gjatë delegimit të përpunimit të të dhënave sipas nenit 20 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave, në portalin <http://medresejatirane.com>.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi i kontrolluesit për të përditësuar në vazhdimësi "Njoftimin" është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 21, 22, 29, 30 dhe 31 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Medreseja "H. Mahmud Dashi", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 05.11.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

